

10 - HAPAT E MARRJES SE BAR KODIT

HAPI 1

MERR NJE PREFIKS TE KOMPANISE GS1

Para se nje kompani te filloje te perdore bar kodet, ajo duhet te krijoje numrat qe do te hyjne brenda ne bar kod. Keto numra quhen Celesa Identifikimi GS1. Hapi i pare ne ndertimin e nje Celesi GS1 eshte marrja e nje Prefiksi te Kompanise GS1 nga nje Organizate Anetare GS1. Prefikset e Kompanise GS1 perdoren per te identifikuar me shume se 1 milione kompani sot dhe formojne themelin e identifikimit unik te gjithckaje ne zinxhirin e furnizimit. Per te marre nje Prefiks te Kompanise GS1, kontaktoni me zyren e GS1 Albania.

HAPI 2

VENDOSJA E NUMRAVE

Pas marrjes se Prefiksit te Kompanise GS1, nje kompani eshte gati te nise vete vendosjen e numrave te identifikimit te produkteve qe ajo tregton, (ose sherbimeve) (si nje ent ligjor vendndodhje, njesi logjistike, kompani asetesh individuale, asetete te kthyeshme dhe marredhenie sherbimesh).

Procesi eshte shume i thjeshte. Ju mesoni sesi te formatoni cdo numer e me pas te perdorni Prefiksin e Kompanise GS1 ne kombinim me numrat e referimit qe keni vendosur. Organizata tuaj anetare e GS1, mund t'ju jape juve informacione specifike mbi sasine e numrave qe ju mund te vendosni ne baze te gjatesise se Prefiksit tuaj te Kompanise GS1.

HAPI 3

ZGJIDHNI NJE METODE TE PRINTUAR BAR KODIMI

Si fillim ju duhet te vendosni se cfare do te bar kodoni dhe nese bar kodi do te mbaje brenda tij informacionin statik ose dinamik. Nje shembull i nformacionit statik eshte nje numer identifikimi produkti (GTIN) per shembull i vendosur mbi nje kuti dritherash. Ndersa shembull i informacioni dinamik jane numrat seriale te printuar mbi etiketat e produkteve.

Nese bar kodi juaj ka informacion statik dhe ju keni nevojte per etiketa me volum me te madhe, atehere ju duhet ti kerkoni nje kompanie printimi qe te printoje etiketat tuaja. Nese keni nevojte per etiketa me volum te vogel ose keni nevojte qe te printoni etiketa me informacion dinamik atehere do te jete e nevojshme te keni ne zyren tuaj nje printer me lazer ose nje printer termal transferues ne magazinën tuaj.

Nje pyetje e rendesishme ne zhvillimin e zbatimit te nje plani bar kodimi eshte menyra sesi mund te printohet nje bar kod. Perseri Organizata Anetare e GS1 do t'ju ndihmoje qe te beni zgjedhjen e duhur dhe shume Organizata Anetare mund te japin ndihmesen e tyre qe ju te gjeni nje printer ne zonen tuaj lokale.

HAPI 4 **ZGJIDHNI NJE MJEDIS SKANIMI “PRIMAR”**

Specifikat per llojin e bar kodit, tipin, madhesine, vendosjen dhe cilesine, te gjitha varen nga fakti se ku do ta skanoni bar kodin.

Ekzistojne 4 – skenare baze skanimi mjedisor per produktet tregtare:

- pako produktesh te skanuara ne pikat e shitjes me pakice (POS)
- pako produktesh te skanuara ne piken e shperndarjes se pergjithshme
- pako produktesh te skanuara ne POS por gjithashtu te skanuara ne mjedise te vecanta shperndarje si me pajisje shenimi per produkte mjeksore
-

Duke ditur se ku do te skanohet bar kodi juaj, ju mund te vendosni per specifikat e duhura per prodhimin e tij. Per shembull, nese nje pako produkti eshte skanuar ne Piken e Shitjes me Pakice (POS) dhe ne shperndarjen e pergjithshme, atehere ju duhet te perdorni nje simbol EAN /UPC per te akomoduar POS-in por duhet ta printoni ate ne madhesi te madhe qe te akomodoni shperndarjen e skanimit dhe te siguroni qe vendosja e tij te plotesoje kerkesat automatike te shperndarjes se skanimit.

Ju mund te gjeni me shume informacione ne Specifikat e Pergjithshme te GS1 ne zyren GS1 Albania.

HAPI 5 **ZGJEDHJA E NJE BAR KODI**

Zgjedhja e bar kodit te duhur eshte themelore per suksesin e planit te zbatimit te bar kodit tuaj, dhe ketu jane disa tipe te nivelit te larte:

Nese ju do te bar kodoni nje produkt tregtar qe do te skanohet ne piken e shitjes me pakice (POS), ju duhet te perdorni nje simbol te EAN/UPC.

Nese jeni duke printuar nje bar kod me informacion te ndryshueshem si per shembull, numra serie, data skadimi ose permasa, atehere ju duhet te perdorni GS1 – 128, DS1 DataBar (RSS), ose ne raste te vecanta Komponentin Perberes, ose Simbolet GS1 DataMatrixs.

Nese doni te printoni nje bar kod me GTIN mbi nje kuti me valezime (rrudha), atehere mund ta zgjidhni vete ITF-14-n. Ka edhe faktore te tjere qe duhen marre parasysh, keshtu qe kontaktoni me zyren GS1 Albania per te pare se cfare menyra sh zbatimi dhe cfare sherbimesh ofrojn.

HAPI 6 **ZGJIDHJA E NJE MASE BAR KODI**

Pasi eshte specifikuar ne menyre te sakte simboli bar kod bashke me informacionin bashkangjitur, atehere fillon faza e dizenjimit. Permasa e simbolit brenda dizanjit do te varet nga simboli i specifikuar, vendi ku do perdoret ai dhe si do te printohet ai.

Simbolet EAN/UPC

Simbolet EAN/UPC ndyshojne nga Simbolet ITF-14 dhe GS1-128, sepse ata skanohen nga skanuesit omni-direktorial te pakices. Kjo do te thote se simbolet EAN/UPC kane nje marredhenie fikse mes lartesis dhe gjeresis se simbolit. Kur nje dimension modifikohet, atehere dimension tjetër duhet te ndryshohet ne sasi proporcionale.

Per shkak te kesaj marredhenie, Simbolet EAN/UPC, kane nje lartesi dhe gjeresi nominale specifike. Gjithashtu eshte specifikuar nje numer permasash te lejueshme qe variojne nga 80% ne 200% te sasise nominale dhe nje numri qe tregon varietetin e dimensioneve mund te gjendet ne Specifikat e Pergjithshme te GS1. Ky varietet permasash shpesh konsiderohet si “Faktoret perforcues” ne rregullat e shit-blerjes qe specifikojne permasat e Simbolit EAN/UPC. Perforcimi minimal, nominal dhe maksimal per Simbolet EAN/UPC eshte ilustruar ne figurat 1.3.1-1.

Perforcimi EAN/UPC

Minimumi (80%)



Nominali (100%)



Maximumi (200%)



Ne menyre qe te rritet permasa e hapesires se simboleve EAN/UPC, shqyrtoni nje dizanj, ne te duhet specifikuar symboli i lartesis ne rritje. Ky process qe quhet (Shkurtim, prerje) nuk lejohet brenda specifikimeve te Simbologjise EAN/UPC dhe per kete arsye duhet shmangur. Kjo ndodh per shkak te ndikimit negative qe ai ka ne perqindjet e skanimit per skanuesit omni-direktoral te pakices.

Kur Simbolet EAN/UPC jane perdorur ne logjistike, transport mallrash dhe shperndarje po ashtu edhe ne Pikat e Shitjes me Pakice (POS), lejohet nje varietet perforcimi nga 150% deri ne 200%. Nje shembull mund te jete symboli ne kuti qe perdoret per kutite e pajisjeve te medha si Televizori apo Mokrovala.

Simbolet ITF-14 dhe GS1-128

Simbolet ITF-14 dhe GS1-128 gjithashtu kane nje numer permasash specifike. Permasat e Simbolit ITF-14 dhe GS1-128 shpesh specifikohen nga gjeresia e Dimensionit – X ne vend te vlerave te perforcimit. Me shume informacion mbi permasat per Simbolet ITF-14 dhe GS1 – 128 bazuar ne aplikimet se ku ata jane perdorur apo ne numrin e identifikimit qe mbajne, mund te gjeni ne Specifikat e Pergjithshme GS1 ne Manuale.

Konsiderata per Procesin e Printimit

Konsiderata me e madhe finale per permasen e simbolit eshte kapaciteti i zgjedhjes se menyres se printimit. Permasa minimale (perforcimi) dhe Reduktimi i Gjerise Bar (BWR) per nje simbol, ndryshon nga procesi i printimit dhe madje dhe nga printimi ne printim. Kompanite e printimit duhet te vendosin nje permase minimale simboli (perforcimi) dhe BWR-je ne menyre qe te arrihen rezultate te pranueshme dhe me cilesi perseritese. Si gjithmone, mund te kontaktoni me GS1 Albania per informacione shtese.

HAPI 7

FORMATIMI I TEKSTIT TE BAR KODIT

Tesksti nen bar kod, eshte i rendesishem per shkak se nese bar kodi demtohet, ose nuk ka cilesi te mire, atehere teksti sherben si perforcues i tij. Menyra me e mire per te mbuluar pyetjet mbi Interpretimin e Lexueshem Human per Simbolet e Sistemit GS1 te Bar Kodit eshte qe ti pergjigjemi disa pyetjeve qe jane bere me shpesh.

A eshte e nevojshme qe Interpretimi i Lexueshem te kete nje permase te caktuar?

Numri i germave te OCR-B fillimisht ishte specifikuar per tu perdorur me Simbolet EAN/UPC, por specifikimet e Sistemit GS1 tani lejojne cdo komplet germash, persa kohe qe ai eshte i lexueshem.

Teksti i lexueshem-human per ITF-14 dhe Simbolet GS1-128 duhet te jete i lexueshem dhe permasat e tij duhet te jene ne proporcion me permasen e simbolit. Per informacione mbi Specifikimet e Pergjithshme GS1 mund te kontaktoni me GS1 Albania.

A duhet qe Interpretimi i Lexueshem te vendoset mbi apo poshte simbolit?

Kjo varet nga simboli qe jeni duke perdorur. Per Simbolet EAN/UPC, referojuni vizatimeve te Specifikimeve te Pergjithshme GS1. Per ITF - 14 dhe Simbolet GS1 – 128, teksti mund te printohet siper ose poshte simbolit ndersa per te dhena te hollesishme kontaktoni me GS1 Albanian.

A eshte e rendesishme vendosja e te dhenave te lexueshme humane poshte bar kodit?

Po. Per Simbolet EAN/UPC te dhenat e lexueshme humane duhet te jene si vizatimet qe i referoheshin pyetjes se mesiperme. Hapesira e te dhenave te Interpretimeve te Lexueshme Humane poshte ITF-14 dhe GS1 – 128, e ben me te lehte leximin e tekstit dhe pranimin e celesit. Ndersa eshte mjaft me vend perfshirja e hapesirave per Interpretimet e Lexueshme Humane dhe hapesirat nuk duhet te kodohen ne simbolet GS1.

Une shikoj kllapa rreth Identifikuesve te Aplikimit (AI) ne Simbolin GS1-128. A duhet qe ata te jene aty dhe a jane koduar ata ne baret dhe hapesirat e simbolit ?

Te gjithë Identifikuesit e Aplikimit (AI) duhet te futen ne kllapa ne Interpretimin e Lexueshem Human, por kllapat nuk perfshihen ne simbol .

Sa shifra duhet te printoj nen Simbolin EAN/UPC ne tekstin e Lexueshem Human ?

Ne menyre absolute dhe pa prejashtim, ju duhet te printoni 12 shifra, asnje me shume apo me pak nen Simbolin UPC-A.

Ne menyre absolute dhe pa prejashtim, ju duhet te printoni 13 shifra, asnje me shume apo me pak nen Simbolin EAN-13.

Ne menyre absolute dhe pa prejashtim, ju duhet te printoni 8 shifra, asnje me shume apo me pak, nen Simbolet UPC-E dhe EAN-8.

HAPI 8 ZGJEDHJA E NGJYRES SE BAR KODIT

Kombinimi me i favorshem i ngjyrave per nje simbol bar kodi, eshte kombinimi i shiritave te zinj me nje sfond te bardhe (Hapesirat dhe Zonat e Qeta). Nese doni te perdorni ngjyra te tjera, menytrat e meposhtme mund t'ju ndihmojne te zgjidhni ate qe ju deshironi.

Simbolet e Bar Kodit GS1 kerkojne ngjyra te erreta per shiritat (per shembull, e zeze, blu e erret, kafe e erret, dhe jeshile e erret). Shiritat gjithmone duhet te perbehen nga nje linje e vetme ngjyre dhe nuk duhet te printohen asnjehere nga imazhe te tjera te shumta si ne forme te sheshte, cilindrike etj.

Simbolet e Bar Kodit GS1 kerkojne sfonde te ndricuara per Zonat e Qeta dhe hapesirat (si per shembull te bardhe). Por pervec sfondeve te bardhe, mund te perdoren edhe ngjyra te (kuqe). Nese keni qene ndonjehere ne nje dhome te erret me ndricim te kuq dhe jeni perpjekur te lexoni nje kopje te kuqe, e dini qe ajo zhduket ne menyre virtuale. Kjo eshte e vertete edhe per ngjyra te ngjashme si portokall, roze, pjeshke dhe e verdhe e hapur.

Duke patur parasysh faktin se shume skanues bar kodesh perdorin nje burim drite te kuqe, mund te shikoni menjehere pse keto ngjyra mund te jene te pershtatshme per sfonde, por nuk duhet te perdoren per shiritat. Ne shume raste nuk printohet sfondi i simbolit. Ajo eshte vete ngjyra e letres se printuar. Nese sfondi i simbolit eshte printuar nen shirita, sfondi duhet te printohet si nje linje ngjyrash solide. Nese perdorni disa shtresa boje shkrimi, per te rritur kapacitetin e sfondit, secila shtrese duhet te printohet si

solide. Nese perdorni nje ekran te mire per te shperndare me shume boje, ne (substratosfere) sigurohuni qe te mos kete asnje boshllek ne printim te shkaktuar nga mos mbushja ne sasine e duhur te printerit.

Perseri, nese qendroni tek shiritat e zinj dhe hapesirat e bardha, ju keni zgjedhur kombinimin optimal, por mund te perdoren edhe kombinime me ngjyra. Konsultohuni me nje printues me eksperience qe mund t'jua rekomandoje GS1 Albania per informacione shtese.

HAPI 9 **VENDNDODHJA E BAR KODIT**

Kur flasim per vendosjen e simbolit ne i referohemi pozicionimit te simbolit ne dizenjim. Kur te caktoni pozicionimin e simbolit duhet te merret ne konsiderate edhe procesi i paketimit. Ju duhet te konsultoheni me inxhinierin e paketimit per tu siguruar qe simboli nuk do te pengohet apo demtohet, (per shembull mbi nje cep kartoni, nen mbeshtjelljen e kartonit, nen kapakun e nje kartoni apo te mbulohet nga nje shtrese tjeter paketimi).

Per te percaktuar vendin e duhur per bar kodet GS1, shikoni seksionet e Specifikimeve te Pergjithshme GS1.

Dizanji i Etiketave Logjistike

Parimet e Pozicionimit te Pergjithshem

Rregulla te Pergjithshme Pozicionimi per Pikat e Shitjeve me Pakice

Rregulla Pozicionimi per Llojet Specifike te Paketimit

Pozicionimi i Simbolit per Aksesoret e Modes dhe Veshjet

Rregulla te Pergjithshme per Etiketat e Veshjeve dhe Aksesoreve te Modes

Rregulla te Pergjithshme Pozicionimi per Pozicionimin e Simbolit ne Produktet e perdorura per Shperndarje

Pasi te percaktoni pozicionimin e duhur, duhet te konsultoheni me pare me kompanine printuese para se te percaktoni rotacionin e simbolit. Kjo per shkak se shume procese printimi kerkojne qe bar kodet te printohen ne nje orientim specifik me drejtimin ushqyes te webit apo fletes.

Nese eshte e mundur, kur te perdorni printimin fleksografik, shiritat (baret) duhet te vendosen paralel me drejtimin e shtypjes te webit ose ne orientimin final. Nese kerkohet qe shiritat te vendosen ne menyre pingul me drejtimin e shtypjes ose ne drejtim te shkalleve, perpiquni te shmangni shtrembimin e simbolit per perimetrin e rrotullimit.

Kur te perdorni qofte sfond te argjende, ose proces printimi (rotogravure), simboli duhet te jete rreshtuar paralel me strukturen e qelizes ne ekran apo (cilindrin e sheshte te printimit) ne menyre qe te jape cepa sa me te sheshte shiritash.

HAPI 10

HARTIMI PER PLANIN CILESOR TE BAR KODIT

Specifikimi i Testit të Cilesisë së Printimit të Bar Kodit ISO/IEC 15416 për Simbolet Lineare, përshkruan një metodë për vlerësimin e cilesisë së simboleve të bar kodeve pasi ato janë printuar.

Një verifikues me bazë ISO, shikon simbolin në mënyrë të tillë si skanuesi, por shkon më tej duke bërë vlerësimin e cilesisë së simbolit.

GS1 përdor metodën ISO/IEC, por specifikon vlerësimin minimal të nevojshëm për çdo bar kod GS1, bazuar në faktin se kush simbol është përdorur, ku është përdorur, apo çfarë numri identifikimi mban. Përveç vlerësimit minimal, GS1 po ashtu specifikon verifikuesit aperturë (hapje, e çarë) të gjerësisë dhe gjatësisë së vales.

Vendosja e specifikimeve minimale të ndryshme është e ngjashme me një universitet që përdor një test standart për të përcaktuar nëse aplikantët e tij do të kualifikohen për praninë. Shumë universitete mund të përdorin të njëjtin test të standartizuar, por secili vendos piket minimale të nevojshme për praninë e aplikanteve të tij.

Seksioni 5.4.2.8 i Specifikimeve të Përgjithshme GS1 ofron një listë të shpejta referencë të specifikimeve të cilesisë së simbolit në varësi të llojit të simbolit, aplikimit apo numrit të identifikimit që mban simboli.

Anëtarët e GS1 mund të vendosin të bëjnë kontrollin e tyre të cilesisë të prodhimit të bar kodit por sot shumë Organizata Anëtare GS1 ofrojnë shërbime për verifikimin e cilesisë së bar kodit.